



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.26, datë 30.04.2007

**PËR  
HEQJEN NGA LISTA E INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
TË CILAT JANË NË TERRITORIN E JURIDIKSIONIT  
TË BASHKISË SË TIRANËS TË ISH DYQANIT TË ARTIKUJVE ARTISTIK**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "e", ligjit Nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", neni 9, Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Nr.1286, datë 26.3.1995, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Marrjen e masave nga Qendra Kulturore "Tirana" për lirimin e dyqanit artistik me qëllim dorëzimin e tij Komunitetit Mysliman.
2. Heqjen nga Lista e Inventarit Kontabël të Qendrës Kulturore "Tirana" të ish-dyqanit artistik me vlerë kontabël fillestare 13.200 lekë dhe njoftimin pranë Drejtorisë së Administrimit të Aseteve.
3. Heqjen nga Lista e pjeshme e Inventarit të Pronave të Paluajtshme të cilat janë në territorin e juridiksionit të Bashkisë së Tiranës të kësaj prone.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Qendra Kulturore "Tirana" dhe Drejtoria e Administrimit të Aseteve.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**SOKOL DERVISHAJ**